



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, merr këtë

V E N D I M

1. **Miratohet** Plani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, Plani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës, është i bazuar në Strategjinë kombëtare për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Plani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2023-2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-561/02-134234/23, më 29.06.2023

KRYESUESI I MBLEDHJES SË KUVENDIT
AJET BRAJSHORI

